



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERIPËRMBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 588/7 prot.

Tiranë, më 07.12.2022

V E N D I M

Nr. 137, datë 07.12.2022

Mbi përfundimin e hetimit administrativ për vlerësimin e zhvillimit të procedurës së konkurrimit kodi #4165; për lëvizje paralele/ngritje në detyrë në kategorinë e mesme edhe të ulët drejtuese, në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Gjeodezisë, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinerike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar”

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në përfundim të procesit të verifikimit të pretendimeve të paraqitura nga konkurrentët ***** dhe *****,

Vërej se:

Pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, përmes kërkesës nr. 580 prot, datë 19.07.2022, dhe shkresës nr. 580/1 prot, datë 04.08.2022, janë parashtruar disa pretendime të kandidatëve ***** dhe ***** , pjesëmarrës në procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinerike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar, publikuar me kodin #4165, në faqen zyrtare të DAP (<http://rekrutimi.administrata.al/shpalljet>), të cilat kanë të bëjnë me probleme organizative, si mungesa e ekspertit të fushës si anëtar i KPND-së dhe më pas edhe për përmbajtjen e procesit, si kryerja e një vlerësimi subjektiv të testimit me gojë, me qëllim favorizimin e kandidatit të shpallur fitues.

Në vijim, për verifikimin e pretendimeve të mësipërme, Komisioneri, me shkresën nr. 580/2 prot., datë 06.09.2022, me objekt: “*Kërkim dokumentacioni për verifikimin e kërkesës së paraqitur nga kandidatët ***** dhe ******, në lidhje më një procedurë konkurrimi”, drejtuar Departamentit të Administratës Publike, ka kërkuar materialet shkresore që pasqyrojnë veprimet administrative të kryera gjatë realizimit të kësaj procedure konkurrimi si dhe informacion nëse ka patur ankesa nga kandidatët pjesëmarrës për këtë procedurë.

Nisur nga përmbajtja e materialeve të administruara, rezulton e vërtetuar se, nëpunësit civilë ekzistues në SHGJSH, ***** dhe ***** , kanë aplikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurrimit për ngritje në detyrë, të shpallur nga DAP, me kod #4165, për pozicionin e punës “*Përgjegjës i Sektorit të Gjeofizikës dhe Gjeodezisë*”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinierike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar.

Referuar shpalljes së publikuar në faqen zyrtare të DAP, për këtë pozicion pune është kërkuar që kandidatët të plotësojnë si kritere të posaçme: Të zotërojnë diplomë “*Master Shkencor*” apo “*Master Profesional*”, në Inxhinieri Gjeologjike/ Inxhinieri Gjeofizike/ Gjeodezi (*Markshajderi*), me diplomë të nivelit “*Bachelor*” në të njëjtën fushë dhe të kenë të paktën 2 vite përvojë pune, në profesion.

Në përfundim të afatit të paraqitjes së dokumentacionit, njësia përgjegjëse, bazuar në pikën 22, të kreut III, të vendimit nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”, i ndryshuar, ka zhvilluar procedurën e verifikimit paraprak dhe në përfundim të saj, në datën 12.07.2022, ka publikuar emrat e kandidatëve të kualifikuar për këtë fazë të konkurrimit, ku konstatohet se janë kualifikuar edhe dy konkurrentët ***** dhe ***** , për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit.

Pas publikimit të listës me emrat e kandidatëve të kualifikuar, për të vazhduar fazën e dytë të konkurrimit, procesi ka vijuar me fazat e tjera, pasi nuk janë paraqitur ankesa nga kandidatët.

Sa i takon pretendimit të kandidatëve se, në përbërje të Komisionit të Përhershëm për Ngritjen në Detyrë, nuk ka pasur ekspertë të fushës, për të cilat po zhvillohej konkurrimi, konstatohet se, KPND është ngritur me urdhërin nr.365 datë 12.07.2022, të DAP dhe në zbatim të pikës 11, kreu III, të VKM-së nr. 242, datë 18.03.2015, i ndryshuar, e cila përcakton se, ekspertët zgjidhen nga pedagogët e universiteteve apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë, ekspertët e lincësuar të fushave të ndryshme apo ekspertët që vijnë nga profesionet e rregulluara dhe që kanë të paktën 5 (pesë) vjet eksperiencë në atë pozicion pune/profesion, dy ekspertët anëtarë të këtij Komisioni, që kanë marrë pjesë në këtë procedurë konkurrimi, janë pedagogë të fushës së gjeologjisë, me mbi 30 vjet përvojë në profesion, ç’ka do të thotë se është respektuar kërkesa ligjore në këtë drejtim.

Në lidhje me pretendimin se, në përfundim të testimit me gojë nuk është kryer një vlerësim objektiv, nga shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se, kandidatët kanë nënshkruar deklaratën për të mos u regjistruar intervista e strukturuar me gojë, duke hequr në këtë mënyrë mundësinë e verifikimit në një kohë të dytë, të saktësisë apo cilësisë së përgjigjeve të dhëna dhe drejtësinë e vlerësimit nga ana e anëtarëve të KPND-së.

Për më tepër, konkurrentët ***** dhe ***** , në datën 15 korrik 2022 (nëpërmjet postës elektronike) janë ankuar në DAP, duke parashtruar pretendimet e mësipërme, në përgjigje të të cilës, në datën 01.09.2022, në ambjentet e DAP, është zhvilluar një takim mes kandidatëve dhe anëtarëve të KPND, lidhur me rezultatin e testimit me shkrim për procedurën me kod #4165, për pozicionin “Përgjegjës i sektorit të Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinerike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë, pranë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar-kategoria III-a/1.

Gjatë këtij takimi konkurrentëve u janë vënë në dispozicion materialet e mëposhtme:

-Teza e testimit me shkrim;

-Fleta e përgjigjeve të testimit me shkrim, të kandidatëve (fleta e kuqe) si dhe raporti i prodhuar automatikisht nga sistemi i kompjuterizuar për vlerësimin e testimit me shkrim, i cili përmban informacion mbi përgjigjet e dhëna nga kandidati dhe përgjigjet e sakta. Në vijim, DAP përmes postës elektronike datë 12.09.2022, i ka kthyer përgjigje kandidatëve mbi pretendimet e tyre.

Në këto kushte, nisur nga përmbajtja e dokumentacionit, në të cilat materializohet procedura e konkurrimit për ngritje në detyrë e shpallur me kod #4165, vlerësohet se Departamenti i Administratës Publike, si nga pikëpamja procedurale ashtu dhe në përmbajtje, ka respektuar të gjitha kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë institutin e rekrutimit, të analizuar në përmbajtje të këtij materiali.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr.152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; bazuar në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe në nenet 16, 34 dhe 35, të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procesit të verifikimit të ligjshmërisë së procedurës së konkurrimit me kod #4165, për pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Gjeofizikës dhe Gjeodezisë”, në Drejtorinë e Gjeologjisë Inxhinerike, Gjeofizikës dhe Gjeodezisë në Shërbimin Gjeologjik Shqiptar,

dhe meqënëse nuk u gjetën veprime apo mosveprime në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil nga ana e njësisë përgjegjëse, arkivimin e çështjes.

2. Të njoftohet për këtë vendim Departamenti i Administratës Publike, institucioni Shërbimi Gjeologjik Shqiptar dhe konkurrentët ***** dhe *****.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha